

V E N D I M
Nr.360, datë 10.7.1995

PËR REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA DHE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Importi i mallrave në Republikën e Shqipërisë është i lirë, me përjashtim të mallrave që me akte ligjore e nënligjore ndalohen të futen në Republikën e Shqipërisë.

2.Eksporti i mallrave nga Republika e Shqipërisë është i lirë, me përjashtim të mallrave të mëposhtme, eksporti i të cilave është i ndaluar:

44.01.10 deri 44.01.22Dru zjarri
44.03.10 deri 44.03.99Trupa druri të papërpunuara
44.07.10 deri 44.07.99Lëndë druri e sharruar dhe binarë
71.12Mbeturina dhe skrape të metaleve të çmuar
72.04Mbeturina dhe skrape të gizës dhe çelikut
74.04Mbeturina dhe skrape të bakrit (me përjashtim të skorejeve të bakrit)

Një pjesë e zërit 74.19.91Artikuj të tjerë prej bakri të derdhura
Mbeturina dhe skrape të nikelit
Mbeturina dhe skrape të aluminit (me përjashtim të amabalazheve të importit prej alumini)
Mbeturina dhe skrape të plumbit
Mbeturina dhe skrape të zinkut
Mbeturina dhe skrape të kallajit

3.Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.135, datë 29.3.1994, dhe nr.16, datë 9.1.1995 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi